



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 29 korrik 2020, në mbledhjen e XXVII-të (njëzet e shtatë) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10:05.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari, përveç Vendenis Lahu i cili mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, Zaim Thaçi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje, ndër të tjera shtoi, besoj që thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj urdhëroni nëse dikush dëshiron fjalën.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, unë dua të bëjë një propozim për seancën e ardhme lidhur me informatën rreth gjendjes së coronavirusit në Komunën tonë, pra që të hyjë si pikë shtesë për mbledhjen e radhës.

z.Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, propozoj që në këtë mbledhje të futet edhe një pikë e rendit të ditës, përkatësisht propozimi për votimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, para se të kalojmë në punë, ju ftoj për 1 minutë heshtje në shenjë respekti për profesorin, pedagogun, aktivistin dhe ish Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, Hazir Raçi i cili ka ndërruar jetë.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të jetës dhe veprës së Hazir Raçit.

Kryesuesi i Kuvendit në vazhdim theksoi, tani përveç pikave të rendit të ditës kemi edhe dy propozimeve për edhe 2 pika shtesë në kuadër të rendit të propozuar të ditës, përkatësisht propozimi i znj.Adelinë Stublla për një informatë rreth gjendjes së pandemisë në Komunën e Podujevës, si dhe propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit për ngritjen e një komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.

z.Mehmet Gashi, theksoi, lidhur me propozimin e koleges së nderuar, nuk e di sa mund të përgatitet një informatë e tillë për seancën e nesërme, ndoshta do të ishte më mirë ta lëmë për mbledhjen e ardhme sepse vetëm të jepet një informatë nga ndokush për këtë kohë shkurtër pa u përgatitur paksa nuk e di sa është e arsyeshme, mirëpo nëse janë të përgatitur dhe nëse janë informatat përkatëse për nesër në mbledhjen e Kuvendit nuk paraqet kurrfarë problemi ne do ta përkrahim, pse jo.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nëse kërkojmë raport të tillë për gjendjen me coronavirus është mirë të njoftohet drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, së paku nga ky moment sepse seanca e radhës është ditën e nesërme. Pra në mënyrë që të mos i themi nesër drejtorit të raportoje ngase nuk e di sa do të mund të raportoje për diçka aty për aty, përndryshe si të dëshironi vendosim unanimisht, për mua nuk paraqet problem.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, vërtetë koha është e shkurtër për një informatë të tillë, mirëpo si do që të jetë këtë propozim të znj.Adelinë Stublla e vë në votim që të përfshihet si pikë shtesë në rendin e ditës dhe t'i rekomandohet Kuvendit për mbledhjen e nesërme.

Njëzëri nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa u mbështet që të përfshihen si pika shtesë në kuadër të rendit të propozuar të ditës (në pikën 4 dhe 5), si vijon:

- ***Informatë nga Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rreth gjendjes së krijuar nga coronavirusi Covid-19 në territorin e Komunës së Podujevës***
- ***Propozimi i Drejtorisë së Arsimit, për ngritjen e Komisionit për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës***

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 29 qershor 2020

z.Mehmet Gashi, theksoi, në procesverbalin e mbledhjes së 29 qershorit kam vërejtur dy gabime teknike; 1-tek emri im ka është një deformim, dhe 2-në vazhdim të diskutimit në atë pjesë ku thuhet se, “.....buxheti duhet të miratohet deri më 31 shtator”, duhet të jetë më datë 30 shtator” sepse muaji shtator i ka 30 ditë..

Njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 29 qershor 2020, përfshirë edhe korrigjimet e gabimeve teknike të paraqitura nga parafolësi.

2. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit mësimor 2019/2020

z.Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, përfundimi i vitit mësimor 2019-2020 shikuar në përgjithësi periudha e parë e vitit shkollor 2019-2020 në Komunën e Podujevës ka përfunduar sipas planifikimeve kurse në periudhat e dytë dhe tretë nuk ka ndodhur e njëjta gjë, periudha e dytë dhe e tretë e këtij viti mësimor është shquar për vështirësi të pa para ndonjëherë si pasojë e krijuar nga pandemia COVID-19. Me shpalljen e pandemisë globale nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2020, nxjerrë vendim nr.01/7, ndër të tjera në pikën 1.1 thuhet, citoj, *ndërprerja e procesit edukativo arsimor në institucionet e arsimit publik dhe privat në të gjitha nivelet deri më 27 mars 2020*. Si pasojë e kësaj gjendje u shfaq nevoja për të gjetur alternativa për vazhdimin e mësimin dhe si reagim ndaj kësaj gjendje të krijuar MASHT përgatiti planin për të vazhduar mësimin në distancë gjë për të

cilën jeni të informuar të gjithë besoj. Me gjithë këtë në këtë proces mësimi në distancë ishte një risi e re në sistemin tonë të arsimit, janë hasur vështirësi dhe sfida të ndryshme si mungesa e mjeteve të përshtatshme mësimore, vështirësi në përdorimin e mjeteve teknologjike nga një pjesë e mësimdhënësve, rrjetin e internetit etj etj. Për ta përballuar më lehtë situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 Drejtoria e Arsimit ka bashkëpunuar ngushtë dhe ka qenë në kontakt të rregullt me Ministrinë e Arsimit si dhe në bashkëpunim me drejtorët e shkollave ju ka përmbytur dhe i ka zbatuar të gjitha vendimet, udhëzimet, rekomandimet nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës.

MASHT ka ndërmarrë hapa konkret në regjistrimin e video materialeve për transmetim në televizionin publik në RTK si dhe plasimin e tyre nëpër platforma të ndryshme të internetit dhe mendoj që ka qenë një përgjigje në kohë e duhur e Ministrisë së Arsimit duke marrë parasysh rrethanat në të cilat gjendeshim në atë kohë edhe rrethanat për të cilat që se dinim se si do të zhvilloheshin ngjarjet, pra siç e ceka në fillim mësimi është ndërprerë për një periudhë të shkurtë kohore me shpresë se do të kthehemi në procesin mësimor, por ajo gjë nuk ndodhi dhe është dashur të vazhdojmë me gjetjen e alternativave për mbajtjen e mësimi. Këto materiale gjegjësisht video materialet kanë filluar të transmetohen fillimisht për nivelin një (1), arsimin fillor më datën 23 mars 2020, pastaj edhe në nivelin dy (2) më datën 6 prill 2020 për klasat gjashtë (6) dhe nëntë (9), dhe për të vazhduar pastaj me arsimin e mesëm të lartë. Ministria e Arsimit ka miratuar një varg të dokumenteve për të bërë të ligjshme këtë mënyrë dhe për ti dhënë karakterin formal organizimit të kësaj forme mësimore. T'ju them të drejtën në fillimisht si Drejtori komunale të Arsimit në nivel vendi kemi pasë shumë dilema me drejtor dhe mësimdhënës shkollash se si do të arrijmë të zhvillojmë mësimin sistematik, si do të arrijmë të bëjmë vlerësimin e njohurive të nxënësve dhe si do të arrijmë përfundimin e vitit mësimor, pra kanë qenë disa dilema por megjithatë është për tu përshëndetur Ministria e Arsimit e cila ka arritur që të gjitha këtyre dilemave dhe pikëpyetjeve të cilat i ngritnim t'iu gjejë zgjidhje.

Një çështje na ka mbetur ende pa e përfunduar që ka të bëjë me këtë vit mësimor, pra organizimi i testit të arritshmërisë dhe testit të maturës, përkundër përgatitjeve të cilat i kemi bërë që këto teste të mbahen më 23 qershor 2020 dhe me 04 korrik 2020 në bazë të vendimit të Ministrisë së Arsimit organizimi i këtyre testeve është shtyrë, pra testi i arritshmërisë është shtyrë për 20 gusht 2020, ndërsa testi i maturës për datën 29 gusht 2020. Ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet, jemi të vetëdijshëm se ka qenë një gjendje sfiduese për të gjithë ne, edhe për ne si udhëheqës të institucioneve edhe për drejtorët e shkollave si udhëheqës të shkollave edhe mësimdhënësve, me një fjalë kemi qenë para një sfide por falë angazhimit të të gjithëve kemi arritur që këtë vit mësimor ta përfundojmë në bazë të rrethanave të krijuara dhe në bazë të dokumenteve, rekomandimeve dhe vendimeve të miratuara nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës.

Viti mësimor 2019/2020 sipas kalendarit të përshtatur për përfundimit të vitit shkollor 2019-2020 si shkak i pandemisë Covid-19, ka përfunduar si vijon; për klasat e XII-ta që janë maturanë viti mësimor ka përfunduar më datë 20 maj 2020, për klasat e IX-ta, të X-ta dhe të XI-ta ka përfunduar më datë 12 qershor 2020, si dhe përfundimi i mësimi për klasat I-ra deri në VIII-ta si dhe grupet para fillore ka përfunduar më datë 06 qershor 2020.

Për fund e shfrytëzoi rastin t'i falënderoi të gjithë mësimdhënësit e Komunës së Podujevës për punën dhe përkushtimin e tyre në organizimin e mësimi në distancë që edhe përkundër shumë sfidave dhe vështirësive arritën ta kryejnë detyrën të cilën shoqëria u ka besuar me përgjegjësi të lartë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë sa po vërej nuk të lajmëruar për të marrë fjalën, a jeni që kjo informatë si pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

3. Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, në përgjithësi rreth furnizimit me ujë dhe problematikat që kemi në raport me kompaninë, furnizimi është i mirë, inkasimi është rreth 75%, por problematikat kryesore janë vështirësitë në mirëmbajtjen e rrjetit të kompanisë dhe dëmet që po shkaktohen në infrastrukturë të cilat disa herë i kemi adresuar në nivelin më të lartë.

Niveli i ujit në liqenin e Batllavës është ngritur pas reshjeve të fundit të shiut dhe për momentin është 5.92 në nivelin maksimal. Investimet për këtë vit që janë duke u bërë nga kompania dhe Komuna janë në disa lokalitete, si në fshatin Sallbajë kompania është duke ripërtërirë rrjetin, pastaj Komuna po ashtu është duke ripërtërirë rrjetin në rr.”Kongresi i Manastirit”, mandej planifikimet e përbashkëta për vitin e ardhshëm posaçërisht është ndërrimi i gypit furnizues në qytet me kapacitet prej 400 mm i cili definitivisht e bënë furnizimin e mirë dhe të plotë të qytetit, është i kushtueshëm llogaritet mbi 400.000,00€ por së bashku me kompaninë dhe donatorët jemi përpjek që vitin e ardhshëm të sigurojmë mjete të mjaftueshme për këtë projekt. Gjithashtu vazhdon projekti në fshatin Orllan, rreth 60% e projektit prej 42 km, Komuna ka kryer obligimet e deri tanishme dhe ka shprehur gatishmërinë që eventualisht në zgjerimet e rrjetit për lagje të jetë bashkëpjesëmarrëse financuese edhe me kompaninë. Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, numri i ekonomive familjare të kyçura në rrjetin përkatës deri tani është 2008, numri i bizneseve është 744, bizneset me kontratë të veçantë janë 82, për më shumë janë të veçuara në informatat e dy kompanive përkatëse. Përfshirja territoriale e menaxhimit të mbeturinave është e mirë mirëpo duhet të punohet më shumë në shtimin e numrit të ekonomive familjare që së bashku me ju dhe me kompanitë nga muaji gusht do të fillojmë fshat për fshat të bëjmë përpjekjen që sa më shumë ekonomi familjare të përfshihen në menaxhimin e mbeturinave.

Po ashtu në informatë janë cekur edhe problematika të ndryshme në qytet që po na përsëriten, me theks deponia ilegale në afërsi të sillosit që asnjëherë nuk po mundemi ta largojmë tërësisht dhe vërtetë tani jemi para dilemave që përveç kontrolleve të inspektorëve dhe të Policisë të vendosim edhe kamerat e vëzhgimit sepse është bërë një dukuri jashtëzakonisht e keqe sepse qytetarë të pandërgjegjshëm po hedhin mbeturina të llojllojshme dhe gjësende tjera afër në atë pjesë e që Kompania “Pastrimi” së paku dy here gjatë ditës bënë shprazjen e kontejnerëve kurse pastrimin e terrenit e bënë së paku dy herë në javë por prapëseprap është e kotë sepse pas dy dite sërish përsëritet e njëjta gjë.

Të gjitha kompanive kontraktuale që kanë punuar ju shpreh një falënderim të veçantë për punën e bërë gjatë periudhës fillestare të shfaqjes së virusit Covid-19, në muajt mars-prill-maj, ku të gjitha kompanitë, qoftë ato mirëmbajtjeve të kanalizimit, mirëmbajtjeve të rrjetit të ndriçimit publik, mirëmbajtjes së rrugëve, larjeve të rrugëve, dezinfektimit, pastaj kompanitë për menaxhimin e mbeturinave, ujësjellësit që janë angazhuar mjaftë mirë, në veçnati për fshatrat që kanë qenë në karantinë duke u përballë me një frikë fillestare siç ka qenë, prandaj i çka sepse vlen të falënderohen.

Sa i përket problematikës rreth furnizimit me energji elektrike, jam duke u marrë me problemet që kemi në raport me kompaninë KEDS nga e cila ka investime jashtëzakonisht të mëdha por ka edhe probleme e që ka rreth dy javë që jemi në takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e KEDS ngase keni vërejtur se ka shumë dinamikë të punimeve në infrastrukturë por që rikthimi i infrastrukturës në gjendje të mëparshme po paraqet probleme dhe pakënaqësi tek qytetarët pastaj, andaj dhe kemi ndërprerje të përkohshme të lejeve ndërtimore dhe infrastrukturore deri sa në qytet t’i zvogëlojmë këto ndërhyrje të kompanive në infrastrukturë publike, pra ka një dinamikë të madhe të punimeve por nuk jemi të kënaqur sa i përket kthimit të infrastrukturës në gjendje të mëparshme.

Gjendja e transportit e që është mjaft e rënduar në tërë Kosovën ne si DSHPMSH kemi vazhduar pa pagesë lejet e linjave për të gjitha kompanitë qoftë të atyre me autobusë, minibusëve, kombibusëve,

kompanive radio dhe auto taksi, në bazë të vendimit të Qeverisë, pra nuk ju kemi kërkuar të bëjnë pagesat e veprimit të biznesit në këtë vit, por sinjerisht prapsepap këto kompani janë në gjendje të rënd si pasojë e rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19.

Te dinamika e projekteve kapitale, në informatë vetëm kam dashur që mënyrë telegrafike të jeni të informuar, pa përfshirë ndonjë hollësi, e di që janë 4-5 pika që mund të diskutojmë bukur shumë por unë jam munduar që informata të jetë sa më e afërt për ju, të pasqyrojmë gjendjen ashtu siç kanë qenë shifrat e fundit të kompanive apo të raportit për secilin rast.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, në parim vlen për tu përshëndetur informatat që kanë sjellë Drejtorët në kuptim të informimit të Kuvendit Komunal për punët të cilat janë bërë dhe për sfidat që përballen.

Unë konkretisht sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim dhe raportit që paraqiti drejtori parafoles, në mesin e të gjitha pikave unë dëshiroj të ndalem paksa tek njëra dhe që vlen të përshëndetet fakti që janë punësuar dy punëtor sezonal për mirëmbajtjen e ambientit të liqenit të Batllavës, mirëpo përveç kësaj mendoj se një sfidë e madhe mbetet edhe mungesa e kontejnerëve në atë pjesë, nuk e di saktë sa është punuar në këtë drejtim për shkak se hera e fundit që kam qenë atje ishte para 10 ditësh dhe për siguri të plotë natyrisht nuk mund të flasë sepse për 10 ditë ndoshta mund të ketë ndryshuar diçka varësisht nga situata. Jam e vetëdijshme që ka pasë një investim më herët por për shkak të njerëzve të pandërgjegjshëm është bërë i gjithë demolomi i kontejnerëve ekzistent, por dua të pyes drejtorin e DSHMSH nëse ka ndonjë plan qoftë përmes donatorëve ose Komuna të bëjë përveç vendimit të më hershëm që ka qenë i domosdoshëm për personat që do të mund t'i bartin mbeturinat, përveç kësaj edhe vendosja e kontejnerëve të rinjë sepse ata që ishin ekzistent po thuajse ishin jo funksional sepse në këtë fazë liqeni i Batllavës është shumë më i frekuentuar, shto këtu faktin edhe të pandemisë që njerëzit kryesisht përqendrohen në hapësira të tilla.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHMSH, sqarim parafolesës, kontejnerët nga rruga kryesore janë larguar afër liqenit në pjesën e fshatit Orllan për arsye se në atë pjesë ku kanë qenë të vendosur ata kontejnerë ka ndodh të shndërrohet si deponi ilegale e mbeturina. Në atë pjesë shumë biznese dhe ekonomi familjare janë të kyçura por tani mbetet të kyçen edhe pjesa e vilave që janë ndërtuar në atë pjesë sepse kemi qytetarë të cilët banojnë vetëm gjatës sezonave të caktua e që jemi duke bërë përpjekje që edhe ata t'i fusim në sistemin sezonal siç e kemi edhe në Rregulloren përkatëse, që ta paguajnë tarifën e menaxhimit përkatësisht marrjes së mbeturinave.

Punëtorët që i kemi angazhuar kanë për detyrë që të bëjnë mbledhjen e mbeturinave të imëta që i hedhin pushuesi, dhe vetëm për këto raste kemi caktuar 2-3 vende së bashku me Kompaninë "Pastrimi" sipas vlerësimeve tona e që kjo komani do t'i dërgon kontejnerët vetëm për këto raste, por jo kontejnerë afër rrugës sepse pastaj po shndërrohet në deponi ilegale e mbeturinave.

Për fatin e keq afër pishave ka sërish hedhje të mbeturinave edhe pse ato mbeturina largohen dhe janë evidentuar ata persona që po i hedhin ato, për fat të keq po hedhin mbeturina dhe po krijohet një lloji deponie ilegale e mbeturinave, por besoj që ata dy punëtorët të cilët kanë punuar edhe më herët janë punëtorë të mirë dhe do t'i mbledhin edhe ato mbeturina, madje sa për njoftim një ditë rastësisht kam kaluar andej dhe i kam parë punëtorët duke bërë largimin e mbeturinave, mirëpo për fat të keq edhe vizitorët në atë pjesë do të jenë në numër më të madh për shkak të situatës së krijuar e që po hedhin mbeturina të ndryshme vend e pa vend. Pra nuk kemi vendosur shporta në vende të ndryshme rreth liqenit sepse po dëmtohen dhe nuk po mirëmbahen, meqenëse nëse punëtorët e vlerësojnë se iu duhen edhe shporta ne do t'i vendosim ato pa problem.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, kush është që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim të kësaj pike në seancën e nesërme.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

➤ **Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rreth gjendjes së krijuar nga coronavirusi Covid-19 në territorin e Komunës së Podujevës**

znj. Adelinë Stublla, si propozuese e kësaj pike, theksoi, ne Grupi i këshilltareve nga radhët e LVV-së propozojmë që në rend të ditës për seancën e nesërme të Kuvendit ta kemi një informatë lidhur me gjendjen e krijuar me Covid-19 në Komunën e Podujevës, gjendje kjo me një numër të madh të të prekurve kur tani dihet edhe për rastet e vdekjeve kështu që e kemi parë të arsyeshme që ta marrim një informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

z. Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike urdhëroni, nëse jo e vë në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për seancën e nesërme që ta kemi një informatë të tillë nga DSHMS.

Njëzëri u mbështet që në mbledhjen e nesërme të Kuvendit të Komunës, të paraqitet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Informata në fjalë.

➤ **Propozimi i Drejtorisë së Arsimit, për ngritjen e Komisionit për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.**

z. Agim Blakçori, drejtor i DKA-së, paraqiti fjalën hyrëse rreth propozimit në fjalë, ndër të tjera theksoi, ky sqarimi kishte të bënte me propozimin që nesër t'i rekomandohet Kuvendit si pikë shtesë e rendit të ditës që të votohet komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve nëpër institucionet edukativo- arsimore në Komunën e Podujevës. Arsye është konkursi i shpallur më datë 23 korrik 2020 dhe bazuar në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Arsimit për detyrat përgjegjësitë procedurat dhe kriteret të zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo arsimor dhe aftësues para universitar me nr. prot.15/2019, në nenin 5 thuhet që komisioni për përzgjedhje të drejtorëve të votohet në Kuvendin Komunal. Përbërja e këtij komisioni duhet të jetë, dy anëtar të propozuar nga Drejtoria e Arsimit ku njëri duhet të jetë nga po kjo Drejtori dhe tjetri të jetë përfaqësues i këshillit të prindërve në nivel komunal, kurse anëtari i tretë caktohet nga MASHT e që pas kërkesës që ne iu bëjmë MASHT dërgon një emër të zyrtares të tyre për të qenë pjesë e komisionit dhe si rrjedhojë përveç tjerash edhe kompletohet komisioni në fjalë, andaj kërkoj që t'i rekomandohet Kuvendit kjo pikë për rend të ditës kur kemi parasysh që konkursi tashmë veç se është hapur ndërsa gjatë muajit gusht sigurisht që Kuvendi do të shkojë në pushim, andaj edhe kërkoj mirëkuptimin e juaj për këtë çështje.

z. Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozimin përkatës të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, dike përfshirë e atë që emrat e anëtarëve të komisionit të paraqiten në seancën e Kuvendit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me theks që emrat e anëtarëve të Komisionit të paraqiten në mbledhjen e Kuvendit, përveç përfaqësuesit të Ministrisë së Arsimit i cili vie sipas detyrës zyrtare.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, para se ta mbyllë këtë mbledhje, tani këtu prezent është edhe Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i cili erdhe paksa me vonesë, andaj edhe vlen që ta informojmë se ne si KPF me iniciativë dhe propozim të këshilltares dhe anëtares së KPF-së znj. Adelinë Stublla që u përkrah nga të gjithë, e futëm si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës këtë informatë të rreth situatës së krijuar nga Covid -19 në Komunën e Podujevës.
Duke ju falënderuar , e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10;40

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0040264/20
Podujevë,
29 korrik 2020

Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi